



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE ✓

Nr. 8089

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: ZOTIT ROBERT JAMES NASO
SHOQERIA "BALKAN RESOURCES" SHPK
RRUGA "ILO MITKE QAFEZEZI" VILA 12

TIRANE

Për njoftim: Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM
SHERBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR
RRUGA E KAVAJES NR.153

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr. 1708 date 23.05.2014

I nderuar zoti Naso,

Shoqëria "Balkan Resources" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr.1708 date 23.05.2014, për mineral bakri, ne Kthelle, Bashkia Mirdite, te Qarkut Lezhe.

Nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me shkresën ne mënyre te përsëritur dhe se fundi me nr. 1545 date 02.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 7189 date 03.11.2015 është propozuar revokimi i lejes nr.1708 date 23.05.2014, sepse nuk janë kryer pagesat e garancive financiare te programit minimal te punës dhe rehabilitimit te mjedisit ne përputhje me pikën 1 e pikën 2, te nenit 31 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për revokim te lejes nr.1708 date 23.05.2014 është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ju keni shkelur germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilen një leje minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.1708 date 23.05.2014, për mineral bakri, ne Kthelle, Bashkia Mirdite, te Qarkut Lezhe.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare ne fjale.

Ne zbatim te pikës nr.7 te nenit 13 dhe nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e lejes se kërkim - zbulimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

